



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:225731
Datë: 28.04.2023
Numri i dokumentit: 04235919
Dosja fizike: C-IV-14-6467

M G B- Prishtinë

Paditësja

Kundër:

Agjencia Kosovare e Privatizimit, me seli në Prishtinë, Rr. "Dritan Hoxha", nr. 55, Lakrishtë

E paditura

DHOMA E POSAÇME E GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS PËR ÇËSHTJET NË LIDHJE ME AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT (Dhoma e Posaçme), gjyqtari Mr.sc. Bajram Miftari, me datën 28.04.2023, mori këtë:

AKTGJYKIM

I. Refuzohet si e pabazuar kërkesëpadija e paditëses M G B, ashtu që VËRTETOHET vendimi i Agjencisë Kosovare të Privatizimit - Autoritetit të Likuidimit PRN093-0554, i datës 17.09.2014, si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Rrethanat procedurale të çështjes

Me datën 29.10.2014, paditësja ka paraqitur ankesë pranë Dhomës së Posaçme, kundër të paditurës Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP), me të cilën e ka atakuar vendimin e Autoritetit të Likuidimit (AL) PRN093-0554, të datës 17.09.2014.

Pala paditëse e ka titulluar parashtrësën si “*ankesë*”, mirëpo gjykata të njëjtën e konsideron si padi, konform nenit 35.1 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, e cila dispozitë bënë trajtimin e barabartë të parashtrësive me të cilat bëhet “*nisja e procedurave*” pran Dhomës së Posaçme, pavarësisht faktit se a quhen padi, kërkesa apo ankesa.

Pala paditëse në padi ndër të tjera ka theksuar: Pranë Autoriteti të Likuidimit ka parashtruar kërkesë kreditore për kompensimin në mjeteve të asistencës sociale nga NSH NBI Gërmia. AL e ka shqyrtuar kërkesën e parashtruar dhe me vendimin e kontestuar kërkesën e parashtruar e ka refuzuar si të pa bazuar. Vendimin e AL-së e ka kontestuar me pretendimin e vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe aplikim të gabuar të dispozitave materiale juridike. E ka kundërshtuar pretendimin e palës së paditur e cila ka theksuar se kërkesa është e parashkruar. Kjo për faktin se me nenin 368 të LMD-së NSH-ja e ka pohuar borxhin me shkresën e datës 23.10.2007. I ka propozuar gjykatës të kërkesëpadinë ta miratoj në tërësi si të bazuar dhe me aktgjykim ta ndryshoj vendimin e AL-së dhe t'ia njohe të drejtën e kompensimit të mjeteve të asistencës sociale. Bashkëngjitur me padinë e ka dorëzuar vendimin e atakuar të AL-së, me shenjën PRN093-0554, të datës 17.09.2014

Me datën 14.04.2022, e paditura ka paraqitur përgjigje në padi, ku ndër të tjera ka theksuar: Objekt i kësaj procedure është vetëm ligjshmëria e vendimit të AL-së, respektivisht përputhshmëria e tij me Ligjin 04/L-034, për AKP-në. Me nenin 74.2 të atij ligji është përcaktuar se ankesat e dorëzuara në Dhomën e Posaçme kundër vendimeve të AL, duhet të bazohen në pretendimin se procesi i likuidimit nuk është kryer në përputhje me Ligjin 04/L-034. Paditësja nuk ka sqaruar se cila dispozitë ligjore është shkelur nga ana e AL me rastin e vendosjes në kërkesën e tij. Me tutje ka theksuar se kërkesa e parashtruar nga pala paditëse është e parashkruar në kuptim të nenit 608 të Ligjit për Punën e Bashkuar, kjo për faktin se parashtruesi është dashur që kërkesën ta parashtroj në gjykatë apo pranë ndonjë organi tjetër kompetent në afatin prej 3 vite nga arritja e kërkesës. I ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë ta refuzoj dhe ta vërtetoj vendimin e Autoritetit të Likuidimit.

Gjendja faktike e konstatuar

Me nenin 8.1 të LPK- së është përcaktuar: *“Se cilat fakte do t'i konsiderojë të provuara e cilat jo, vendosë vetë gjykata në bazë të çmuarjes me ndërgjegje, e të kujdesshme të provave, por edhe në bazë të rezultatit të gjithë procedimit. Gjykata me ndërgjegje dhe me kujdes e çmon çdo provë veç e veç dhe të gjitha provat së bashku”.*

Me qëllim të vërtetimit të saktë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata iu është referuar fakteve të prezantuara nga palët në procedurë dhe provave të bashkëngjitura nga palët në procedurë.

Pala paditëse ka dorëzuar këto prova: Vendimin mbi caktimin e përkohshëm të punëtorëve në punë dhe detyra të punës të datës 02.11.2004; shkresën e palës së paditur për prova shtesë; dhe vërtetimin e datës 10.06.2004.

Në këtë çështje juridike, gjykata ka shqyrtuar dhe analizuar të gjitha parashtrimet e palëve në procedurë dhe ka shqyrtuar provat e lëndës sipas rregullave që përcakton neni 8 i LPK-së dhe dispozitat e tjera procedurale të ndërlidhura.

- Në vlerësimin e kësaj çështje kontestimore, gjykata ka ardhur në përfundimin se pala paditëse ka parashtruar kërkesë pranë AL-së me të cilën ka kërkuar kompensimin e

shumës prej 1,500.75, në emër të kompensimit të mjeteve të asistencës sociale si punëtore e NSH Gërmia. Autoriteti i Likuidimit në vendimin e tij ka theksuar se pala paditëse nuk ka prezantuar prova të mjaftueshëm dhe me shkresën e datës 20.08.2014, ka kërkuar informata dhe prova shtesë. Pala paditëse përkundër kërkesës së palës së paditur nuk ka prezantuar provat e kërkuara. Rrjedhimisht AL me vendimin me numër PRN093-0554, të datës 17.09.2014, kërkesën e parashtruar nga pala paditëse në atë procedurë e ka refuzuar si të pa bazuar. Paditësja me padi e ka kontestuar vendimin në fjalë duke pretenduar se AL nuk ia ka zbatuar drejtë dispozitat ligjore dhe ka pretenduar se kërkesa e tij gjen mbështetje ligjore, mirëpo nuk ka parashtruar prova për të vërtetuar pretendimet e dhëna me padi. Nga ana tjetër, pala e paditur e ka kontestuar kërkesëpadinë me pretendimin se kërkesa është e parashkruar.

- Gjykata me datën 10.08.2022, ka lëshuar urdhër për palën paditëse ku ndër të tjera i ka kërkuar të parashtrroj kundërpërgjigje në padi. Nga shkresat e lëndës vërtetohet se urdhri në fjalë i është dorëzuar palës paditëse me datën 08.09.2022, mirëpo përkundër këtij fakti pala paditëse nuk është përgjigjur në urdhër dhe nuk ka prezantuar prova për të vërtetuar pretendimet e dhëna me padi, e rrjedhimisht pretendimet e saj kanë mbetur të pa provuara.

Arsyetimi ligjor

Procedura gjyqësore pran Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet në Lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në vazhdim: Dhoma e Posaçme), është e rregulluar me Ligjin për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet në Lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Ligji nr. 06/L-086, i publikuar në gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, nr. 12/27, Qershor 2019), si ligj special. Përveç kësaj, si ligj procedural i përgjithshëm zbatohet Ligji për Procedurën Kontestimore (Ligji nr. 03/L-006), me ndryshimet dhe plotësimet e mëvonshme. Kjo çështje është definuar me Ligjin për Dhomën e Posaçme, neni 76, paragrafi 3, ku është theksuar, se *“në interpretimin dhe zbatimin e këtij ligji, kudo që është e nevojshme për të zgjidhur një çështje procedurale që nuk trajtohet mjaftueshëm me këtë ligj, Dhoma e Posaçme do të zbatojë mutatis mutandis dispozita përkatëse të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore”*.

Ligji për Dhomën e Posaçme, neni 74, i jep të drejtën palës (kreditorit në procedurë të likuidimit) që të ushtroj mjetin juridik - ankesën kundër vendimit të AL-së, pran Dhomës së Posaçme. Sipas të njëjtës dispozitë ligjore, Dhoma e Posaçme mund të nxjerrë aktgjykim për vërtetimin, shfuqizimin apo ndryshimin e vendimit të AL-së, varësisht prej epilogut të procesit gjyqësor dhe në zbatim të dispozitave ligjore të aplikueshme.

Gjykata fillimisht ka shqyrtuar se a është e nevojshme mbajtja e seancës dëgjimore me palët në procedurë apo çështja mund të vendoset në bazë të materialeve në lëndë. Këtë çështje nuk e adreson Ligji për Dhomën e Posaçme si ligj special, por vetëm LPK si ligj procedural i përgjithshëm. Me LPK, neni 4, është përcaktuar se:

- Neni 4.1: Gjykata vendos për kërkesëpadinë pas shqyrtimit të çështjes juridike në seancë të drejtpërdrejtë dhe publike.

- Neni 4.2: Ndryshe nga dispozita e paragrafit 1 të këtij neni, gjykata vendosë për kërkesëpadinë në bazë të veprimeve procedurale të shkruara dhe provave të administruara në mënyrë jo të drejtpërdrejt, po që se kjo përcaktohet me ligj.

Një rast të tillë të përcaktuar me të njëjtin ligj ku mund të merret vendim meritore pa pasur nevojë që të mbahet seancë dëgjimore, e kemi të rregulluar me nenin 399 të LPK-së, ku është përcaktuar si në vijim:

- Neni 399.1: Kur gjykata, pasi t'i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadiës, atëherë ajo do të jep vendimin meritore me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadija.
- Neni 399.2: Kërkesëpadija është e pathemeltë, në vështrim të paragrafit 1 të këtij neni, po që se qartazi është në kundërtënie me faktet e treguara në padi, apo, po që se faktet mbi të cilat mbështetët kërkesëpadija qartazi janë në kundërtënie me provat të cilat i ka propozuar paditësi, apo me faktet që janë botërisht të ditura.

Gjykata, pas shqyrtimit të dosjes së lëndës ka ardhur në përfundimin se nga faktet e treguara apo të prezantuara nga pala paditëse në padi, nuk del themelësia e kërkesëpadiës. Përkundrazi, mbi bazën e të gjitha fakteve siç i ka prezantuar pala paditëse në padi rezulton se kërkesëpadija nuk është e bazuar. Prandaj, edhe janë plotësuar kushtet ligjore për të zbatuar nenin 399 të LPK-së.

Vendimi i AL-së i atakuar me padi, pohon se paditësi nuk e ka justifikuar shumën e kërkuar prej 1,500.75 €. Prandaj, “barra e të provuarit” i ka takuar palës paditëse që të dëshmojë faktet mbi të cilat e bazon kërkesën e saj. Sipas vlerësimit të gjykatës, pala paditëse nuk e ka mbështetur kërkesën e saj në fakte dhe prova konkrete.

Gjykata tërheqë vëmendjen më tutje se me Ligjin për Dhomën e Posaçme, neni 31 (Obligimet e palëve në procedurë), është përcaktuar:

Palët, në parashtrësit e tyre me shkrim, duhet të paraqesin një pasqyrë gjithëpërfshirëse të fakteve që ato palë i dinë, apo me arsye besojnë të jenë relevante apo materiale për kërkesën, lëndën, procedurën apo rastin përkatës. Dhoma e Posaçme sipas detyrës zyrtare bën hetimin e fakteve vetëm në rrethana të jashtëzakonshme. Dhoma e Posaçme duhet t'i inkurajojë palët që të arrijnë zgjidhje me negociata para dhe gjatë cilësdo procedurë. Në të gjitha fazat e procedurave gjyqësore, palët veprojnë në mënyrë të singertë. Secila palë, në parashtrësit e saj me shkrim, duhet të paraqesë një pasqyrë të hollësishme të fakteve dhe arsyesimit ligjor mbi të cilin vendos qëndrimin dhe argumentimin e saj. Në rastin kur pala pohon të ekzistojë një fakt, ajo palë është e obliguar të paraqesë prova, fizike dhe/ose dëshmuese, për mbështetjen e atij pohimi”.

Pastaj, me nenin 42, paragrafi 2 dhe 3 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, është përcaktuar se

Pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtrësas apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese). Secilës palë tjetër do t'i jepet mundësia e arsyeshme për ta kontestuar legjitimitetin apo saktësinë e provave të tilla, nëpërmjet paraqitjes së parashtrësave apo provave tjera (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese) ... Pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë. Nëse pala e tillë dështon që të paraqesë apo dorëzojë provat e tilla, atëherë vlerësohet se pala nuk ka ofruar barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë.

Edhe me nenin 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, është përcaktuar se palët kanë për detyrë t'i paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla.

Konform këtyre dispozitave ligjore të cituara më sipër, rezulton se ka qenë në përgjegjësinë ligjore të palës paditëse që të argumentoj pretendimin e saj se për cilat arsye i takon e drejta në kompensimin e mjeteve nga asistenca sociale si ish i punësuar në Ndërmarrje. Siç është shtjelluar më sipër, paditësi ka dështuar që të ofroj argumentet faktike dhe ligjore, në mbështetje të kërkesës së tij, qoftë me padinë e parashtruar qoftë me ndonjë parashtrësë të mëvonshme.

Duke u bazuar në faktet dhe rrethanat e lartë përmendura dhe në zbatim të dispozitave ligjore të cituara më sipër, gjykata ka ardhur në përfundimin se janë përmbushë kushtet ligjore për të nxjerrë vendim meritore (aktgjykim) në këtë fazë të procedurës shkresore dhe se seanca mbajtja e seancës dëgjimore në këtë rast, është e panevojshme.

Duke marrë për bazë parimin e barrës së provës, gjykata ka ardhur në përfundimin se pala paditëse me provat e prezantuara nuk ka mundur që t'i argumentoj pretendimet nga padia.

Pas një procesi të vlerësimit ligjor të fakteve të prezantuara nga palët në procedurë dhe shqyrtimit të të gjitha provave materiale të ofruara prej tyre, gjykata ka ardhur në përfundimin se kërkesëpadia nuk është e bazuar në ligj, ndaj, të njëjtën e ka refuzuar në tërësi.

Shpenzimet gjyqësore

Vendimi për shpenzimet procedurale është marrë në bazë të nenit 62.5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, ku është përcaktuar se “Nëse pala e suksesshme nuk i kërkon shpenzimet ose nëse ashtu vendos Dhoma e Posaçme, atëherë secila palë i bartë shpenzimet e veta”. Në këtë rast gjyqësor, asnjëra nga palët në procedurë nuk ka kërkuar kompensimin e shpenzimeve procedurale. Prandaj, gjykata ka vendosur që secila palë do të bartë shpenzimet e veta.

Udhëzimi juridik

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim pranë Dhomës së Posaçme, brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e dorëzimit të tij, e cila i drejtohet Kolegjit të Apelit pranë Dhomës së Posaçme, konform nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Gjyqtari,
Mr.sc. Bajram Miftari